



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planuar / Dorezuar Pitiljeño/Prodato Received/Delivery	22.12.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	8381/2022		1/13



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.943/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.769/2022 të datës 05.09.2022 dhe ankesën me numër A.nr.943/2022 të datës 25.11.2022 të parashtruar nga ankuesi të cilat sipas Vendimit me Nr. 138/2022 të datës 31.10.2022 janë bashkuar në një ankesë të vetme me numër A.nr.943/2022, të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat me adresë Rruga kundër Vendimit me Nr. 09/2022 të datës 17.10.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike "largim nga shërbimi civil", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 22.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.943/2022 të datës 25.10.2022 të parashtruar nga ankuesi

II. Shfuqizohet Vendimi me Nr. 09/2022 i datës 17.10.2022 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të bëjë zbatimin e tij duke e kthyer ankuesin në pozitën sipas Akt Emërimit me Nr. 862/2012 të datës 13.04.2012, si dhe duke bërë kompensimin e pagave nga dita ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në zbatimin e këtij vendimi, si dhe të bëjë shuarjen e kësaj mase disiplinore në pajtim me këtë vendim.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 22.07.2022 ka nxjerr Vendim A.nr.313/2022 përmes të cilit ka aprovuar pjesërisht ankesën e ankuesit duke ndryshuar masën disiplinore sipas Vendimit KD Nr.05/2021 të Komisionit Disiplinor nga masa disiplinore *“largim nga shërbimit civil”* në masën disiplinore *“Ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për katër (4) vjet”*.

Pas pranimit të këtij vendimi, Ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, më datë 16.08.2022 ka inicuar procedurën disiplinore ndaj ankuesit në Komisionin Disiplinor me pretendimet që disa nga çështjes të cilat janë ngritur paraprakisht nuk janë shqyrtuar as nga organi i shkallës së parë e as nga organi i shkallës së dytë.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit më datë 23.08.2022 ka nxjerr Vendim me Nr. 06/2022 me të cilin ka bërë pezullimin nga detyra të ankuesit deri në përfundimin e procedurës disiplinore, ndërsa më datë 16.09.2022 Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka nxjerr Vendim me Nr. 07/2022 përmes të cilit ka bërë shtyrjen e afatit për përfundimin e procedurës.

Ankuesi më datë 05.09.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 5138/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 06/2022 të datës 23.08.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, më datë 17.10.2022 ka nxjerr Vendim me Nr. 09/2022 përmes të cilit ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore *“largim nga shërbimi civil”*.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr. 09/2022 të datës 17.10.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, më datë 25.10.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 6437/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 01.11.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Ndërsa Këshilli, me datë 10.11.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Për shkak të shkak që faktet dhe baza ligjore për vendimmarrje janë të njëjta, Kryetari i Kolegjit për shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka parashtruar kërkesë për bashkimin e ankesave të ankuesit, ndërsa Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 31.10.2022 ka nxjerr Vendim VK.Nr.138/2022 përmes të cilit ka bërë bashkimin e ankesës

me numër A.nr.769/2022 të datës 05.09.2022 dhe ankesës me numër A.nr.943/2022 të datës 25.11.2022 të parashtruar nga ankuesi

Për shkak të kompleksitetit të lëndës, Kryetari i Kolegjit për shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka parashtruar kërkesë për shtyrjen e afatit për vendosje për dhjetë ditë punë, ndërsa Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 06.12.2022 ka nxjerr Vendim VK.Nr.182/2022 përmes të cilit ka bërë shtyrjen e afatit për vendosje për dhjetë ditë punë për ankesën e ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesën e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me nr. Protokollin 6437/2022 të datës 25.10.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë me Nr. Prot: 6622/2022 të datës 01.11.2022; Akt emërim i lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës për ankuesin me Nr. Port: 862/2012 të datës 13.04.2012; Përshkrimi i Detyrave të punës i lëshuar nga Ministria e Kulturës , Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës me Nr. Port: 1033/2/2013 të datës 26.03.2013; Paraqitje e shkeljeve të detyrave zyrtare dhe rekomandim për fillimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit me detyrë Udhëheqës i Divizionit për Prokurim Publik në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës me numër protokollin 3610/2022 të datës 16.08.2022; Vendim Nr.07/2022 i datës 16.09.2022 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës për ankuesin me Nr. Prot: 4196/2022 të datës 16.09.2022; Vendimi me Nr. 09/2022 i datës 17.10.2022 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Procesverbal i lëshuar nga Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës të datës 12.10.2022; Procesverbal i lëshuar nga Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës të datës 13.10.2022; Procesverbal i lëshuar nga Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës të datës 17.10.2022; Vendim i lëshuar nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës për ankuesin me Nr. Protokollin 3583/2022 të datës 15.08.2022; Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Kulturës , Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës për Vitin 2021; Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Kulturës , Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës për Vitin 2020; Listë Distribuimi - Kërkesë për inicim të procedurave të lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës me Nr. Port: 2971/2020 të datës 03.09.2020; Njoftim për AQP-në lidhur me aktivitetin e prokurimit; Listë Distribuimi-Shërbimet e prodhimit të sporteve televizive dhe dokumentarëve për nevoja afatgjate (36 muaj kalendarike) të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Institucioneve vartëse me Nr. Port: 3153/2020 të datës 22.09.2020; Përshkrimi i Çmimeve - Shërbimet e prodhimit të sporteve televizive dhe dokumentarëve për nevojat e Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit; Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit të datës 04.09.2020; Pjesa B: Kontrata Kornizë & Kushtet Speciale & Anekset e Ndërlidhura në mes Ministrisë së Kulturës , Rinisë dhe Sportit - "Autoritetit Kontraktues " dhe " të datës 22.02.2021; Pjesa II e Kontratës - Kushtet e Përgjithshme; Pjesa III e Kontratës - Kushtet e Veçanta; Prokurimi i tenderit me kod:

207-20-6138-2-1-1 me numër të brendshëm: 207-20-089-2-1-1 të datës 17.11.2020; Përshkrimi i Çmimeve - Shërbimet e prodhimit të sporteve televizive dhe dokumentarëve për nevojat e Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit; Njoftim për dhënie të Kontratës të lëshuar nga Ministria e Kulturës dhe ÇJK të datës 30.12.2020; Urdhër Pagesë e lëshuar nga Ministria e Kulturës , Rinisë dhe Sportit me numër të zotimit 2021-39813 të datës 11.11.2021; Raport i Pranimit të lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me numër të raportit të pranimit të mallit 2021-50269 të datës 10.11.2021; Urdhër Blerje e lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me numër urdhër blerje 2021-48071 të datës 05.11.2021; Kërkesë për mallra dhe shërbime të lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me numër kërkesë 2021-42595 të datës 14.09.2021; Kërkesë zotimi për blerje të lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me numër kërkesë 2021-42595 të datës 17.08.2021; Faturë e lëshuar nga me Nr.008/08/21 të datës 08.08.2021; Lista e Akomodimit të Filharmonisë së Kosovës të Projektit e datës 07.08.2021; Raport mbi punën e kryer të lëshuar nga Filharmonia e Kosovës të datës 09.08.2021; Vendim i lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me Nr. Port: 2778/2021 të datës 16.08.2021; Kërkesë për lejimin e ekzekutimit të pagesave të shpenzimeve të projektit koncentral të datës 07.08.2021 në Prishtinë me Nr. Port: 2617/2021 të datës 03.08.2021; Vendim i lëshuar nga Filharmonia e Kosovës të datës 30.07.2021; Plani i punës së Filharmonisë së Kosovës për muajin Gusht 2021; Kontratë e lidhur mes Filharmonisë së Kosovës dhe më datën 05.08.2021; Formulari i Certifikimit të dokumentacionit para regjistrimit të shpenzimit në SIMFK të lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit më datën 11.11.2021; Urdhër Pagesë të lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me numër të zotimit 2021-45212 të datës 24.11.2021; Raport i pranimit të lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me Nr.2021-50430 të datës 16.11.2021; Urdhër Blerje të lëshuar nga Ministria e Kulturës , Rinisë dhe Sportit me Nr.2021-48341 të datës 04.11.2021; Kërkesë për mallra dhe shërbime të lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me Nr.2021-48523 të datës 13.10.2021; Kërkesë zotimi për blerje të lëshuar nga Ministria e Financave-Thesari I Kosovës me Nr.48523 të datës 13.10.2021; Formulari i Regjistrimit të Dokumentacionit të lëshuar nga Ministria e Financave-Thesari i Kosovës 26.11.2021; E-mail zyrtar i datës 13.10.2021 nga SH.RR për I.A; E-mail zyrtar I datës 26.10.2021 nga I.A për SH.RR; Kërkesë për akomodim dhe mbulim të shpenzimeve për bashkëpunëtorët e jashtëm për projektim e ri " Tanzminiaturen & Tangata" nga Baleti Kombëtar i Kosovës të datës 17.08.2021; Fatura për Baletin Kombëtar të Kosovës nga N.T.G " Blendi" me Nr.2217-210-001-21 të datës 14.09.2021; Raport mbi planin e aktivitetit të Baletit Kombëtar të Kosovës me Nr.69 të datës 16.09.2021; Fletëpranim i mallrave-shërbimeve të lëshuar nga Ministria e Kulturës , Rinisë dhe Sportit - Departamenti i Administratës Qendrore të datës 14.09.2021; Urdhër pagese e lëshuar nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit me Nr.zotimi 2020-53734 të datës 17.12.2020; Raport i pranimit i lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me numër të shënimeve të pranimit të mallit 2020-52936 të datës 25.11.2020; Urdhër blerje të lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me Nr.2020-54119 të datës 25.11.2020; Urdhër pagese të lëshuar nga Ministria e Kulturës , Rinisë dhe Sportit me Nr.2020-54513 të datës 17.12.2020; Raport I Pranimit të lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me Nr.2020-53194 të datës 30.11.2020; Urdhër blerje të lëshuar nga Ministria e Kulturës , Rinisë dhe Sportit me Nr.2020-544513 të datës 26.11.2020; Kërkesë për mallra dhe shërbime të lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me Nr.2020-56901 të datës 17.11.2020; Kërkesë zotimi për blerje të lëshuar nga Ministria e Financave - Thesari i Kosovës me Nr.2020-

56901 të datës 11.11.2020; Kërkesë zyrtare për shpenzime të lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me kod: 815 të datës 14.10.2020; Vendim i lëshuar nga Ministria e Kulturës , Rinisë dhe Sportit me Nr.67/2020 të datës 14.10.2020; Faturë e lëshuar nga Gllareva me Nr.36/2020 të datës 27.09.2020; Kërkesë e lëshuar nga lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit- Departamenti i trashëgimisë kulturore e datës 05.09.2020; Programi për aktivitetet "Ditët e trashëgimisë evropiane" 15.09.2020-31.10.2020; Raport i lëshuar nga lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit-Departamenti i trashëgimisë kulturore të datës 30.09.2020; Formulari i Certifikimit të Dokumentacionit para regjistrimit të shpenzimit në SIMFK të datës 17.12.2020; Urdhër obligimi për pagesë të lëshuar nga lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me Nr. zotimi 2019-9979 të datës 18.04.2019; Urdhër blerje të lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me Nr.2019-11238 të datës 25.03.2019; Raport i pranimit të lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me Nr.2019-10753 të datës 25.03.2019; Kërkesë për mallra dhe shërbime të lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me Nr.2019-10028 të datës 13.03.2019; Kërkesë zotimi për blerje me Nr.10028 të datës 13.03.2019; Letër Distribuimi - Kërkesë për mbulimin e shpenzimeve për akomodimin e ekspertëve të së drejtës së autorit në konferencën rajonale të ZDA-së të datës 03.12.2018; Faturë e lëshuar nga Hotel " Parlament " SH.P.K me Nr.609/18 të datës 04.12.2018; Certifikatë regjistrimi të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Agjencioni i Regjistrimit të Bizneseve me Nr.70572958 të datës 12.02.2010; Certifikatë e Nr. Fiskal e lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave - Administrata Tatimore e Kosovës me Nr.600464383 të datës 27.04.2010; Certifikatë- Deklaruese i TVSH e lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave-Administrata Tatimore e Kosovës me Nr.330112053 të datës 26.01.2011; Konferenca Rajonale: Të drejtat e autorit në kohën digjitale të datës 05.12.2018; Urdhër pagese e lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me Nr.2019-22865 të datës 05.06.2019; Raport i pranimit të lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me Nr.2019-23414 të datës 31.05.2019; Raport i pranimit të lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me Nr.2019-23413 të datës 24.05.2019; Urdhër për blerje të lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me Nr. 2019-22865 të datës 20.05.2019; Kërkesë për mallra dhe shërbime të lëshuar nga Ministria e Kulturës , Rinisë dhe Sportit me Nr.2019-21472 të datës 06.05.2019; Kërkesë zotimi për blerje të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave me Nr.21472 të datës 06.05.2019; Faturë e lëshuar nga "Dukagjini" SH.P.K me Nr.022491001 – 74 të datës 24.02.2019; Listë Distribuimi - Kërkesë e lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të datës 20.02.2018; Akomodim i MKRS 22-23.02.2019, 23-24.02.2019 I lëshuar nga Hotel "Dukagjini" të datës 24.02.2019; Ekipi punues për hartimin e Projektligjit për Filharmonisë- Operën dhe Baletin të lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të datës 22.02.2019; Urdhër pagesë e lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me Nr.22020-5416 të datës 24.04.2020; Raport i pranimit i lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me Nr.2020-5110 të datës 24.02.2020; Raport i pranimit i lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me Nr.2020-5109 të datës 24.02.2020; Urdhër blerje e lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me Nr.2020-5416 të datës 20.02.2020; Kërkesë për mallra dhe shërbime të lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me Nr.2020-5692 të datës 14.02.2020; Kërkesë zotimi për blerje me Nr.2020-5692 të datës 14.02.2020; Listë distribuimi - Kërkesë e lëshuar nga Ministria e Kulturës , Rinisë dhe Sportit me datën 10.10.2018; Faturë e lëshuar nga me Nr.102118001-74 të datës 21.10.2018; Plani i veprimit për vitin 2018 të

Muzeut të Kosovës; Listë Distribuimi – Kërkesë e lëshuar nga Ministria e Kulturës , Rinisë dhe Sportit me datën 13.11.2019; **RASTI 4**; Raporti i pranimit i lëshuar nga Ministria e Kulturës , Rinisë dhe Sportit me Nr.2022-3664 të datës 23.02.2022; Urdhër blerje e lëshuar nga Ministria e Kulturës , Rinisë dhe Sportit me Nr.2022-4253 të datës 25.02.2022; Kërkesë për mallra dhe shërbime të lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me Nr.2022-5683 të datës 24.02.2022; Kërkesë zotimi për blerje e lëshuar nga Ministria e Financave – Thesari i Kosovës me Nr.2022-5683 të datës 09.02.2022; Raport i pranimit të lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me Nr.2021-47761 të datës 29.10.2021; Urdhër blerje të lëshuar nga Ministria e Kulturës , Rinisë dhe Sportit me Nr.2021-46319 të datës 26.10.2021; Kërkesë për mallra dhe shërbime të lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me Nr.2021-47673 të datës 11.10.2022; Kërkesë zotimi për blerje të lëshuar nga Ministria e Financave – Thesari i Kosovës me Nr.47673 të datës 11.10.2021; Listë Distribuimi – Kërkesë e lëshuar nga Ministria e Kulturës , Rinisë dhe Sportit të datës 16.04.2021; Faturë e lëshuar nga _____ me Nr. Protokolli 1471/2021 të datës 21.06.2021; Faturë e lëshuar nga _____ me Nr.1453-210-001-21 të datës 21.06.2021; Fletëpranim i mallrave i lëshuar nga lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit-Departamenti i Administratës Qendrore të datës 21.06.2021; **RASTI 3**; Listë Distribuimi – Kërkesë për inicim të procedurës së prokurimit të lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me Nr. Protokolli 1505/2018 të datës 10.05.2018; Kërkesë për hartimin e Projektit teknik të sistemit kundërzjarrit, klimatizimit dhe mbrojtjen nga lagështia në Depot e ASHAK-së me numër referencë 05 Nr.104/2018 të datës 26.04.2018; Kërkesë për mallra dhe shërbime të lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me Nr. 2018-19017 të datës 23.04.2018; Kërkesë zotimi për blerje e lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave me Nr.19017 të datës 23.04.2018; Formulari për Kërkesë i lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të datës 06.04.2018; Kërkesë e lëshuar nga Ministria e Kulturës , Rinisë dhe Sportit-Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës me Nr.Protokolli 01/53/19 të datës 22.02.2019; Identifikimi i autoritetit kontraktues i lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me Nr.Protokolli 4783/2019 të datës 11.11.2019; Identifikimi i autoritetit kontraktues i lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të datës 26.06.2018; Kontratë në mes Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe “B.M GROUP” SH.P.K me numër identifikues: 207-19-8203-5-2–1 (207-19-094-5-2-1) të datës 20.08.2020; Parashtresë e lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit- Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës me Nr. Protokolli 01/103/21 të datës 23.04.2021; E-mail zyrtar i datës 08.06.2021 nga B.Z për H.Ç; E-mail zyrtar i datës 02.07.2021 nga B.Z për B.R; E-mail zyrtar i datës 24.08.2021 nga B.R për “B.M GROUP”; E-mail zyrtar i datës 03.08.2021 nga N.C për B.R; Krahasimi i specifikave teknike të gjeneratorëve aerosol për fikjen ndaj zjarrit ; E-mail zyrtar i datës 29.07.2021 nga N.C për M.H; E-mail zyrtar i datës 26.07.2021 nga “B.M GROUP” për N.S; E-mail zyrtar i datës 21.09.2021 nga B.Z për H.Ç; E-mail zyrtar i datës 01.09.2021 nga I.M për B.R; E-mail zyrtar i datës 27.08.2021 nga B.R për “
E-mail zyrtar i datës 11.08.2021 _____ E-mail zyrtar I datës 03.08.2011 nga N.C për B.R; E-mail zyrtar i datës 01.08.2021 nga M.H për N.C; E-mail zyrtar I datës 29.07.2021 nga N.C për M.H; E-mail zyrtar i datës 26.06.2021 nga “B.M GROUP” për N.C; E-mail zyrtar i datës 23.07.2021 nga A.M për I.M; E-mail zyrtar i datës 06.10.2021 nga I.A për B.G , N.C , B.Z , R.P , Xh.H , M.H , A.M , “ BM GROUP”; E-mail zyrtar i datës 21.09.2021 nga B.Z për H.Ç; E-mail zyrtar i datës 21.09.2021 nga I.M për B.R; E-mail zyrtar i datës 01.09.2021 nga “B.M GROUP” për I.M; E-mail zyrtar i datës 27.09.2021 nga B.R (ankuesi) për

“B.M GROUP”; E-mail zyrtar i datës 11.08.2021 nga B.R për “B.M GROUP”; E-mail zyrtar i datës 03.08.2021 nga N.C për B.R; E-mail zyrtar i datës 01.08.2021 nga M.H për N.C; E-mail zyrtar i datës 29.07.2021 nga N.C për M.H; E-mail zyrtar i datës 26.07.2021 nga “B.M GROUP” për N.C; E-mail zyrtar I datës 23.07.2021 nga A.M për I.M; Procesverbali me z.v Sekretarin I.A të datës 22.10.2021; E-mail zyrtar i datës 06.10.2021 nga I.A për “ B.M GROUP”, N.C , B.Z , R.P , XH.H , M.H , A.M ,I.M; E-mail zyrtar i datës 21.09.2021 nga B.Z për H.Ç; E-mail zyrtar u datës 01.09.2021 nga I.M për B.R ; E-mail zyrtar i datës 01.09.2021 nga B.G për I.M; E-mail zyrtar i datës 27.08.2021 nga B.R për B.G; E-mail zyrtar i datës 11.08.2021 nga B.R për B.G; E-mail zyrtar i datës 03.08.2021 nga N.C për B.R; E-mail zyrtar i datës 01.08.2021 nga M.H për N.C; E-mail zyrtar i datës 29.06.2021 nga N.C për M.H; E-mail zyrtar i datës 26.07.2021 nga “B.M GROUP” për N.C; E-mail zyrtar i datës 23.07.2021 nga A.M për I.M; Njoftim me E-mail zyrtar të datës 04.11.2020 nga N.C për SH.A, B.G, B.Z; Kontrata: 207-19-8203-5-2-1 të lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të datës 07.10.2021; Renovimi i Arkivit të Kosovës me E-mail zyrtar të datës 06.11.2020 nga N.C për B.R; Kërkesë për njoftim me E-mail zyrtar të datës 12.11.2020 nga N.C për R.P; Njoftim me E-mail zyrtar të datës 16.11.2020 nga R.P për N.C; Renovimi I depos së Arkivit Shtetëror të Kosovës me E-mail zyrtar të datës 03.12.2020 nga N.C për SH.A , B.G; Njoftim me E-mail zyrtar të datës 11.12.2020 nga N.C për R.P; Renovimi i Depos së Arkivit Shtetëror të Kosovës me E-mail zyrtar të datës 14.12.2020 nga N.C për A.M ; E-mail zyrtar I datës 14.12.2020 nga A.M për N.C; Renovimi i Arkivit Shtetëror të Kosovës me E-mail zyrtar të datës 15.12.2020 nga N.C për B.R; Renovimi i Arkivit Shtetëror të Kosovës me E-mail zyrtar të datës 29.12.2020 nga N.C për I.M; E-mail zyrtar i datës i datës 28.12.2020 nga I.M për N.C; E-mail zyrtar i datës 22.12.2020 nga I.M për N.C; E-mail zyrtar i datës 17.12.2020 nga I.M për N.C; Renovimi i Arkivit Shtetëror i Kosovës me E-mail zyrtar të datës 29.12.2020 nga N.C për I.M dhe B.R; E-mail zyrtar i datës 28.12.2020 nga I.M për N.C dhe B.R; E-mail zyrtar i datës 17.12.2020 nga I.M për N.C; Renovimi i Arkivit Shtetëror të Kosovës me E-mail zyrtar i datës 23.04.2021 nga B.R për I.M dhe N.C; E-mail zyrtar i datës 22.04.2021 nga I.M për N.C; Kërkesë - Renovimi i depos së Arkivit shtetëror të Kosovës me E-mail zyrtar të datës 18.03.2021 nga N.C për R.P dhe I.M; Kërkesë - Renovimi i depos së arkivit së shtetëror të Kosovës me E-mail zyrtar të datës 03.11.2021 për V.B; E-mail zyrtar i datës 02.11.2021 për B.R ; E-mail zyrtar i datës 31.05.2021 nga N.C për B.R; E-mail zyrtar i datës 31.05.2021 nga I.M për N.C; Çështja e arsimit për shuarjen e zjarrit në objektin e Arkivit të Shtetit të Kosovës me E-mail zyrtar të datës 24.06.2021 nga B.Z për I.A , J.SH dhe R.P; E-mail zyrtar i datës 21.06.2021 nga I.A për B.Z , J.SH dhe R.P; E-mail zyrtar I datës 21.06.2021 nga B.R për I.A dhe F.H; E-mail zyrtar i datës 21.06.2021 nga I.A për F.H; E-mail zyrtar i datës 21.06.2021 nga B.R për I.A; E-mail zyrtar i datës 09.06.2021 nga A.D; E-mail zyrtar i datës 08.06.2021 nga B.R për A.D; **RASTI 2**; Listë Distribuimi-Kërkesë- Inicim të procedurës së prokurimit për projektin e parkut dhe bazamentit të shtatores së Fadil Vokrrit e lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me Nr.Protokolli 916/2020 të datës 26.11.2020; Kontratë në mes Ministrisë së Kulturës , Rinisë dhe Sportit dhe ÇJK (në vazhdim “Autoriteti Kontraktues”) dhe Grupi i Operatorëve Ekonomik Paramasa e punimeve ndërtimore për projektin : Rregullimi I lokacionit për Shtatoren “Fadil Vokrri”; Prokurimi ME Nr. 207-20-8109-5-3-6 me Nr. të brendshëm: 207-20-120-536 për Punimin e rregullimit të lokacionit për shtatoren “Fadil Vokrri” i datës 07.12.2020; E-mail zyrtar i datës 28.12.2020 nga B.R për F.A; Njoftim për nënshkrimin e kontratës të datës 11.10.2021 e lëshuar nga Ministria e

Kulturës , Rinisë dhe Sportit; Vendim i lëshuar nga Ministria e Kulturës , Rinisë dhe Sportit me Nr.Protokolli 1694/2021 të datës 27.05.2021; E-mail zyrtar i datës 26.05.2021 nga F.H për F.K; E-mail zyrtar i datës 26.05.2021 nga I.A për F.H; E-mail zyrtar i datës 26.05.2021 nga B.R për F.H dhe D.B; E-mail zyrtar i datës 15.01.2021 nga F.A për B.R; Komisioni i vlerësimit të tenderëve i datës 20.10.2020; Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues të lëshuar nga Ministria e Kulturës , Rinisë dhe Sportit të datës 20.10.2020; Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm; Letër standard për (tenderuesin) (kandidatin) e eliminuar; Njoftim për dhënie të kontratës të datës 05.11.2020 të lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe ÇJK; Kontratë në mes Ministrisë së Kulturës , Rinisë dhe Sportit dhe N.SH. AMC - Prishtinë me datën 06.11.2020; Prokurimi : 207-20-5988-2-3-6 me nr. të brendshëm 207-20-093-236 për Shërbime audio inqizimi live në studio për ansamblin "SHOTA" i datës 06.10.2020; Njoftim për nënshkrimin e kontratës të datës 12.03.2021 të lëshuar nga Ministria e Kulturës , Rinisë dhe Sportit; **RASTI 1 - PJESA 2;** Kërkesë për Audio inqizim live dhe në studio të programit artistik të lëshuar nga Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve " SHOTA" me Nr.protokolli 2587/20 të datës 28.07.2020; Kërkesë për Audio inqizim live dhe në studio të programit artistik të lëshuar nga Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve " SHOTA" me Nr.protokolli 2587/20 të datës 28.08.2020; Kërkesë për Audio inqizim live dhe në studio të programit artistik të lëshuar nga Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve "SHOTA" me Nr.protokolli 2587/20 të datës 01.10.2020; Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve të datës 24.09.2020; E-mail zyrtar i datës 24.09.2020 nga E.K për INFOAQP; Raport i vlerësimit të tenderëve I datës 14.10.2020 I lëshuar nga Ministria e Kulturës , Rinisë dhe Sportit dhe ÇJK; Vendim I lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të datës 08.12.2020; Njoftim për nënshkrimin e kontratës të lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe ÇJK të datës 14.01.2021; Njoftim për dhënie të kontratës të lëshuar nga Ministria e Kulturës , Rinisë dhe Sportit dhe ÇJK të datës 01.12.2020; Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues të lëshuar nga Ministria e Kulturës , Rinisë dhe Sportit të datës 18.11.2020; Letër standard për tenderuesin e suksesshëm; Letër standard për (tenderuesin) (kandidatin) e eliminuar; **RASTI 1;** Listë distribuimi- Kërkesë për inicim procedure të lëshuar nga Ministria e Kulturës , Rinisë dhe Sportit me datën 07.10.2020; E-mail zyrtar i datës 26.03.2021 nga E.K për B.R; E-mail zyrtar i datës 13.10.2020 nga SH.N për B.R dhe E.K; E-mail zyrtar i datës 12.10.2020 nga B.R për SH.N dhe E.K; E-mail zyrtar I datës 12.10.2020 nga SH.N për B.R dhe E.K; E-mail zyrtar i datës 12.10.2020 nga B.R për SH.N dhe E.K; E-mail zyrtar I datës 07.10.2020 nga SH.N për B.R dhe E.K; E-mail zyrtar I datës 07.10.2020 nga B.R për E.K; Specifikimi teknik i lëshuar nga Departamenti I Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme/Divizioni për Teknologji të Informacionit dhe Shërbimeve Logjistike të Ministrisë së Kulturës , Rinisë dhe Sportit; Kontratë në mes Ministrisë së Kulturës , Rinisë dhe Sportit dhe " GLOBAL CONSULTING & DEVELOPMENT ASSCIATES" e datës 03.12.2020; Prokurimi: 207-20-6672-2-3-6 me Nr.të brendshëm: 207-20-100-2-3-6 të Shërbimeve për përkthim dhe lektorim për nevoja të MKRS-së të datës 26.10.2020; Formulari për dorëzimin e tenderit; Formulari i paraqitjes së kuotimit të Çmimit të datës 26.10.2020; Formulari i përshkrimit të Çmimit të datës 26.10.2020; Vendimin VK.Nr.138/2022 të datës 31.10.2022 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin VK.Nr.182/2022 të datës 06.12.2022 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji i Këshillit, konstaton se inicimi i procedurës disiplinore ndaj ankuesit më datë 16.08.2022 është bërë me arsyetimin që Komisioni Disiplinor në rastin e parë kur ka trajtuar rastin e ankuesit nuk ka shqyrtuar të gjitha pretendimet e inicuesit të procedurës disiplinore, andaj në kuptim të kësaj bëhet edhe kërkesa e re për inicim të procedurës disiplinore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, fillimisht ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit kundër Vendimit me Nr. 06/2022 të datës 23.08.2022 të Komisionit Disiplinor lidhur me pezullimin e tij nga detyra dhe pretendimin për inicimin e procedurës disiplinore.

Fillimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se me Vendimin A.nr.313/2022 të datës 22.07.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil është aprovuar pjesërisht ankesa e ankuesit duke ndryshuar masën disiplinore sipas Vendimit KD Nr.05/2021 të Komisionit Disiplinor nga masa disiplinore *"largim nga shërbimit civil"* në masën disiplinore *"Ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për katër (4) vjet"*, ndërsa si rezultat i kësaj, Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, më datë 12.08.2022 ka nxjerr Vendim me Nr. 118/2022, i cili është protokolluar më datë 15.08.2022 për zbatimin e Vendimit A.nr.313/2022 të datës 22.07.2022 të Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil dhe ankuesi është kthyer në vendin e punës, ndërsa përfaqësuesi i ankuesit Vendimin me Nr. 118/2022 e ka pranuar përmes emailit nga Sh.I më datë 17.08.2022.

Duke marr parasysh faktin që me datë 16.08.2022 ndaj ankuesit është inicuar procedurë disiplinore në Komisionin Disiplinor, Kolegji i Këshillit, vlerëson se ende ankuesi pa marr njoftim për kthim në vendin e tij të punës sipas Vendimit A.nr.313/2022 të datës 22.07.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të njëjtë i është inicuar një procedurë e re disiplinore për pretendimet të njëjta.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit kundër Vendimit me Nr.06/2022 të datës 23.08.2022 të Komisionit Disiplinor lidhur me pezullimin e tij nga detyra, Kolegji i Këshillit, vlerëson se inicimi i procedurës disiplinore ndaj ankuesit më datë 16.08.2022 është bërë ende pa u kthyer ankuesi në vendin e tij të punës, dhe në këtë kuptim po ashtu edhe mbi bazën e gjendjes faktike të njëjtë, shkelje që janë trajtuar në vendimin paraprak të këshillit, meqenëse ankuesi sipas Vendimit A.nr.313/2022 të datës 22.07.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil ka një masë disiplinore në fuqi për shkelje të rënda disiplinore mbi bazë të një konstatimi të njëjtë të gjendjes faktike, atëherë pezullimi i ankuesit nga detyra mbi këtë bazë është i pabazuar dhe rrjedhimisht edhe kundërligjor.

Lidhur me vendimmarrjen nga ana e Komisionit Disiplinor, ndaj kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore, Kolegji i Këshillit, i'u referuar nenit 12 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, i cili përcakton se: *"Komisioni disiplinor duhet të marrë vendim brenda 30 ditëve pas pranimit të kërkesës për iniciim të procedurës nga njësia për burime njerëzore"*, mirëpo Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, lejon organin administrativ të bëjë shtyrjen e përfundimit të procedurës administrative respektivisht neni 99 paragrafi 2 kanë përcaktuar se: *"2. Shtyrja sipas paragrafit 1 të këtij neni, do të bëhet për aq kohë sa është e nevojshme për të përfunduar procedurën administrative dhe duhet të jetë në përpjesëtim me kompleksitetin e çështjes konkrete, por nuk mund të jetë më e gjatë se afati fillestar. Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit, konstaton se shtyrja e afatit për të përfunduar procedurën administrative bëhet vetëm në rast kur lënda është komplekse dhe kërkon dëshmi shtesë lidhur me rastin, ndërsa sipas Vendimit me Nr. 07/2022 të datës 15.09.2022 të Komisionit Disiplinor, shtyrja e afatit për përfundimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesi është bërë vetëm për shkak që ka pasur shumë shkresa dhe është e pamundur të trajtohen të gjitha shkresat brenda afatit.*

Kolegji i Këshillit, konstaton se Vendimi me Nr.07/2022 i datës 15.09.2022 i Komisionit Disiplinor është i protokolluar më datë 16.09.2022, në këtë rast ankuesi respektivisht përfaqësuesi i tij nuk është njoftuar brenda afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh nga data e iniciimit të procedurës disiplinor lidhur me vendimmarrjen, në këtë rast është vepruar në kundërshtime me nenin 99 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Vendimi procedural i shtyrjes të afatit fillestar dhe data e re e mbarimit të tij, i njoftohet palës, brenda afatit fillestar dhe duhet të jetë e arsyetuar"* dhe nenin 12 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Meqenëse në bazë të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë nuk është ndaluar ankesa kundër vendimit për pezullim nga puna të nëpunësit civil, dhe po ashtu në bazë të nenit 125 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, është përcaktuar se: *"Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative")"*, rrjedhimisht ankuesi kundër Vendimit me Nr. 06/2022 të datës 23.08.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, më datë 05.09.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe për këtë ka qenë e njoftuar edhe ministria mirëpo e njëjtë nuk ka bërë pezullimin e procedurës sipas nenit 130 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, parashtrimi i një ankese pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën"*, kështu që pretendimet e ankuesit janë të bazuara.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit kundër Vendimit me Nr. 09/2022 të datës 17.10.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kolegji i Këshillit, në bazë të shqyrtimit të provave të lëndës, konstaton se fillimisht ndaj ankuesit më

datë 07.10.2021 është inicuar procedurë disiplinore nga Ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Komisionin Disiplinor për të njëjtat pretendime si ceken edhe në kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore të datës 16.08.2022.

Si rezultat i kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore të datës 07.10.2022, Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit përmes Vendimit KD Nr.05/2021 të datës 05.11.2021 ka trajtuar kërkesën dhe të gjitha pretendimet e ngritura në këtë kërkesë, rrjedhimisht Komisioni Disiplinor sipas Vendimit KD Nr.05/2021 të datës 05.11.2021 për të gjitha shkeljet e pretenduara ndaj ankuesit ka shqiptuar masën disiplinore "largim nga shërbimi civil", ndërsa pas ankesës së ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil Kosovës, më datë 22.07.2022 përmes Vendimit A.nr.313/2022 të datës 22.07.2022 është aprovuar pjesërisht ankesa e ankuesit duke ndryshuar masën disiplinore sipas Vendimit KD Nr.05/2021 të Komisionit Disiplinor nga masa disiplinore "largim nga shërbimi civil" në masën disiplinore "Ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për katër (4) vjet".

Bazuar në këtë, Kolegji i Këshillit, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes Vendimit A.nr.313/2022 të datës 22.07.2022 ka konstatuar se ankuesi ka bërë shkelje të rënda disiplinore, por ka vlerësuar se masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit "largim nga shërbimi civil" është masë e rëndë në raport me shkeljen disiplinore, në kuptim të kësaj, Kolegji, konstaton se sipas nenit 21 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: "1. Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës. 2. Zbatimi i vendimit duhet të bëhet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit të Këshillit. 3. Moszbatimi i vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i institucionit, paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës".

Andaj bazuar në Vendimin A.nr.313/2022 të datës 22.07.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes të cilit është vendosur përfundimisht për rastin e ankuesit, Kolegji i Këshillit, konstaton se Ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit nuk ka pasur asnjë të drejtë të parashtrojë kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit për çështjet për të cilën është vendosur përfundimisht nga një organ kompetentë ,andaj edhe kërkesa është në kundërshtim me Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, rrjedhimisht Vendimi me Nr. 09/2022 i datës 17.10.2022 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit është nxjerr si rezultat i shkeljeve procedurale dhe materiale, për faktin se nuk ka dëshmi se është ftuar në seancë të Komisionit Disiplinor inicuesi i procedurës disiplinore, rrjedhimisht kemi shkelje të nenit 12 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, i cili përcakton se: "Komisioni disiplinor kryen edhe këto veprime deri në marrjen e vendimit: Fton iniciuesin dhe nëpunësin civil ndaj të cilit është inicuar procedura disiplinore për t'u njohur me variantin e tyre të ngjarjes apo të problemit". Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka shqyrtuar kërkesën për të cilën ky komision paraprakisht për një kërkesë të njëjtë ka shqiptuar masën e

njëjtë, si rezultat i kësaj ky vendim është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që masa disiplinore është në kundërshtim dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, si rezultat i kësaj në raport me ankuesin janë shkelur parimet e përgjithshme të menaxhimit të zyrtarëve publikë të përcaktuar me nenin 7 paragrafi 1 të këtij ligji i cili përcakton se: *“Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë”*, andaj pretendimet e ankuesit janë të bazuara.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Sekretari i Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, është i obliguar që të bëjë zbatimin e këtij vendimi, respektivisht brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duhet ta kthejë ankuesin në vendin e tij të punës sipas aktit të emërimit me numër 862/2012 të datës 13.04.2012 në pozitën “Drejtor i Departamentit të Prokurimit” me të gjitha të drejtat që burojnë nga marrëdhënia e tij e punës, duke bërë kompensimin e pagave nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në zbatimin e këtij vendimi dhe të bëjë shuarjen e masës disiplinore nga dosja e tij të shqiptuar sipas Vendimit me Nr. 09/2022 i datës 17.10.2022 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: *“Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës”*, ndërsa me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të këtij ligji është përcaktuar se: *“Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit”*.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.943/2022, datë 22/12/2022

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.